



BULETIN INFORMATIV

Ambasada Suedeze organizon aktivite në qytetin e Beratit



Me datë 30 Mars 2022, Ambasada Suedeze në Tiranë zhvilloi një grup aktivitetesh në Qytetin e Beratit nën moton "Ambasada vjen tek ju" (Pop-Up Embassy).

Në këto grup aktivitetesh mori pjesë i gjithë personeli i ambasadës i kryesuar nga Ambasadorja Znj. Elsa Håstad.

Gjithashtu ishin të pranishëm dhe Drejtuesi i Ekipit të Menaxhimit të Programit SCPA, Z. Ansi Shundi, Drejtori i Policisë Rrugore në DPPSH, specialistë të Sektorit të Policimit në Komunitet në DPPSH, punonjës policie të DVP Berat, etj.

Personeli i ambasadës suedeze kishte ardhur me një autobus i cili ishte dekoruar me flamurin suedez dhe hashtag-un: #DriveforDemocracy.

Pjesa e parë e këtij aktiviteti përfshiu takime të personelit të ambasadës me autoritetet vendore të Bashkisë Berat duke vazhduar me aktivite në Bulevardin Republika të Qytetit me njerëzit, nxënësit dhe partnerët e tyre kudo që ata janë.

Në këto takime u mblodhën partnerë të ambasadës suedeze nga bashkia e Beratit, shoqëria civile përfshirë organizatat që zhvillojnë projekte të financuara nga SCPA, organizatat e grave, aktivistët e mjedisit, aktivistët për të drejtat e komunitetit rom dhe oficerë të Policimit në Komunitet.

Pjesëmarrësit në këtë event shprehën interes të veçantë ndaj aktivitetit të Shoqatës GBi – Health & Safety Academy, grantmarrëse e raundit të 5-të të skemës së granteve të Programit SCPA, të cilët me pajisjet simulatore dhe me trajnerët e saj organizuan një seancë trajnimi mbi drejtimin e sigurt të mjetit.

Qëllimi i këtyre takimeve ishte për tu takuar me njerëzit dhe për të ndarë historinë e bashkëpunimit midis Suedisë dhe Shqipërisë.

Pasditë u zhvillua një ndeshje futbollit në stadiumin "Tomorri" me ekipit të ambasadës dhe bashkisë së Beratit dhe dita u mbyll me shfaqjen e filmit 'Catwalk' ('Pasarela') në bibliotekën "Vexhi Buharaja".

Aktivitetet e muajit Mars 2022

AKTIVITETET KRYESORE:

- ◆ **Ambasada Suedeze organizon aktivite në qytetin e Beratit**
- ◆ **Seminar trajnues me Specialistët e Rendit dhe të Sallave të Drejtimit dhe Komandimit të DVP Tiranës, Durrësit dhe Fierit**
- ◆ **Takim me përfaqësues të komunitetit në qytetin e Sarandës.**
- ◆ **Policimi në komunitet dhe studentë të Universitetit Shkodër**
- ◆ **Siguria në internet dhe të rinjtë.**
- ◆ **Takim mbi fenomenin e dhunës me gjimnazistë të Pogradecit**
- ◆ **Përvoja pozitive të bashkëpunimit të të rinjve me Policinë e Shtetit.**
- ◆ **Aktivitet ndërgjegjësues mbi sigurinë në rrugë me nxënësit e gjimnazit "Partizani" të Tiranës.**
- ◆ **Takime me të rinj mbi policimin në komunitet, Librazhd**

Seminar trajnues me Specialistët e Rendit dhe të Sallave të Drejtimit dhe Komandimit të DVP Tiranës, Durrësit dhe Fierit



Gjatë muajit mars 2022, u zhvillua konsolidimin e zbatimit të tyre në praktikë. seminarin në formë trajnimiti në DVP Tiranë, Durrës dhe Fier.

Në keto seminare morën pjesë përkatësisht 73 punonjës policie nga DVP Tiranë, 29 nga DVP Durrës dhe 38 nga DVP Fier.

Pjesëmarrësit në këtë seminar ishin Specialistët e Rendit me funksion Përgjegjës Turni të Patrullës së Përgjithshme dhe specialistë dhe ndihmës specialistë të sallës së Drejtimit dhe Komandimit nga DVP Tiranë (6 komisaritet e Tiranës + komisaritetin e Kavajës të Vorës dhe postës së policisë Farkë dhe Qytetit të Studentit; nga DVP Durrës (Komisaritet e Durrësit, Krujës, Shijakut dhe Stacioneve të policisë së Fushë Krujës, Plazhit, Rogozhinës si dhe të Postës së Policisë Manzë); nga DVP Fier (Komisaritet e Fierit, Lushnjës, Mallakastrës, dhe Divjakës si dhe postave të policisë së Patosit).

Ekipi i SCPA përbëhet nga Eksperti vendor dhe Koordinator i SCPA. Objektivi i seminarit ishte forcimi i rolit të specialistit të rendit me funksion përgjegjës i patrullës së përgjithshme sa u takon detyrave që mbart ky funksion dhe

Gjatë seminarit bashkëbiseduesit trajtuan gjerësisht ndryshimet që janë duke u zbatuar me hyrjen në fuqi të përshkrimeve të reja të punës për Oficerët e Patrullës së Përgjithshme (OPP) dhe Ndihmës-Specialistëve të Policimit në Komunitet (NSPK), si dhe në detyrat e angazhimit e reja që këto ndryshime kanë sjellë jo vetëm për këto struktura por edhe për të gjithë zinxhirin e komandës.

Këto grup seminaresh synojnë:

- të rrisin kuptimin e kompetencave profesionale të Përgjegjësve të Turnit të Patrullës;
- të identifikojnë e forcojnë aftësitë e tyre individuale;
- të konsolidojnë më tej njohjen e detyrave të kësaj strukture;
- të identifikojnë format e mbështetjes për oficerët e patrullës së përgjithshme në raste emergjente si dhe ndarjen më të mirë të punës mes OPP dhe NSPK/SPZ.

Takim me përfaqësues të komunitetit në qytetin e Sarandës.



Në datën 17 Mars 2022, Shoqata e Gruas "Jona", grantmarrëse e raundit VI të skemës së granteve, në bashkëpunim me Sektorin e Policimit në komunitet, pranë Komisaritet Sarandë, organizoi tryezën informuese me anëtarë të grupeve vullnetare. Pjesëmarrës në këtë tryezë ishin anëtarë të komunitetit, oficerë të policimit në komunitet, koordinatorja vendore për dhunën pranë Bashkisë dhe përfaqësues nga institucione anëtare të Mekanizmit Koordinues të Referimit të rasteve të DHF. Qëllimi i këtij takimi ishte njohja me rolin dhe përgjegjësitë e oficerit të policimit në komunitet dhe e institucioneve të tjera anëtare të mekanizmit, çështje që lidhin komunitetin me policinë, bazën ligjore për bashkëpunim, të drejtat dhe detyrat e çdo grup interesi dhe rëndësinë e këtyre grupeve si urë komunikimi midis policisë dhe komunitetit si dhe aspekte të tjera praktike.

Ky takim u zhvillua në kuadër të projektit "Rritja e bashkëpunimit komunitet-policie për parandalimin e dhunës në familje".



Policimi në komunitet dhe studentë të Universitetit Shkodër.



Në kuadër të projektit “Fuqizimi i policimit në komunitet në Shqipëri” si pjesë e skemës së granteve, më 31 mars 2022 u organizua një sesion ndërgjegjësues me studentë të Departamentit të Edukimit Fizik dhe Sporteve të Universitetit Luigj Gurakuqi. Dhuna psikologjike, emocionale dhe fizike mes të rinjve në aktivitetet sportive ishte pjesë e diskutimit. Roli i mësuesve mbi rëndësinë e trajtimit të bulizmit në shkollë në bashkëpunim me policinë

si dhe ndërhyrjet e kësaj të fundit. Pjesë kyçe e diskutimit u bë roli i policisë në eventet sportive, rëndësia e prezencës së saj gjatë këtyre eventeve, edhe kur ato janë amatore, si dhe efektiviteti i bashkëpunimit të policisë me pjesëmarrjen dhe arbitrimin e aktiviteteve. Ky aktivitet u zbatua nga shoqata Albanian Water Sports and Tourism. GBI.

Siguria në internet dhe të rinjtë.



Më datë 28 mars u zhvillua një aktivitet informues dhe ndërgjegjësues mbi sigurinë në internet me temë “Keqpërdorimi i të dhënave personale”. Ky aktivitet u zhvillua në shkollën 9-vjeçare publike “Skender Çaçi” në kuadër të projektit “Rritja e efikasitetit të parandalimit të dhunës në njësinë administrative nr. 8 Tiranë”. Interneti tashmë nuk është më një risi për fëmijët dhe të rinjtë por një nevojë e domosdoshme për ata.

Zhvillimi i vullshëm i teknologjisë në vitet e fundit shoqërohet njëkohësisht edhe ekspozimin e fëmijëve ndaj risqeve të shfaqura si

rrjedhojë e lundrimit jo të sigurt të fëmijëve në internet.

Qëllimi i aktivitetit ishte informimi dhe ndërgjegjësimi i të rinjve për sigurinë në internet dhe për rreziqet e mundshme ndaj të cilave ata mund të ekspozohen gjatë përdorimit të internetit dhe se si ata të shmangin rreziqet e botës virtuale dhe se si mund të reagojnë kur përballesh me to.

Punonjësi i policimit në komunitet i pranishëm në këtë aktivitet u foli nxënësve edhe për njësinë e hetimit të krimit kibernetik pranë Policisë së Shtetit e cila kryen mbikëqyrje aktive online.

Takim mbi fenomenin e dhunës me gjimnazistë të Pogradecit.



Shoqata “Unë, Gruaja” në datën 18 mars 2022 realizoi forumin ndërgjegjësues me gjimnazistë nga shkolla “Selim Gjona” Njësia Administrative Proptisht, Pogradec. Në takim morën pjesë nxënës të shkollës, përfaqësues nga Komisariati i Policisë Pogradec, përfaqësues nga NJMF, shkolla si edhe përfaqësuese nga shoqata “Unë, Gruaja”. Qëllimi i takimit ishte informimi dhe sensibilizimi i të rinjve mbi dhunën sidomos atë kibernetike, problemet sociale e ekonomike që sjell në shoqëri, martesat e hershme, përdorimi i drogave pasojat që sjell ajo në familje, etj. Një nga temat e prezantimit ishte ligji i dhunës në familje, Kodi Penal dhe veprat penale ku përfshihen më së shumti të rinjtë. Gjithashtu u fol mbi rëndësinë që ka trajtimi i këtyre fenomeneve që në fillesa dhe në mënyrë të koordinuar nga të gjithë institucionet. Një nga pikat e diskutimeve ishte partneriteti me policinë dhe informimi ligjor për nxënësit, mësuesit dhe prindërit, sa i rëndësishëm është bashkëpunimi në parandalimin e të tilla fenomeneve, etj. Ky aktivitet u organizua në kuadër të projektit “Polici, Institucione dhe Shoqëri Civile së bashku për Sigurinë Publike”.



Përvoja pozitive të bashkëpunimit të të rinjve me Policinë e Shtetit.



Më 25 mars 2022, në Njësinë Administrative Pajovë, Bashkia Peqin, nxënës të shkollës e mesme “Mustafa Kemal Atatürk” në bashkëpunim me Komisariatin e Policisë Peqin, patrulluan së bashku me patrullën e policisë në rrugën nacionale Elbasan-Peqin dhe monitoruan respektimin e rregullave të qarkullimit rrugor nga përdoruesit e automjeteve. Aktiviteti u realizua me mbështetjen dhe nën kujdesin e Zyrës Arsimore. Aktiviteti u lehtësua nga organizata “Në familje, për

familjen”, grantmarrëse e raundit të 5-të të skemës së granteve, e cila po zbaton në Qarkun e Elbasanit projektin “Zhvillimi i qëndrueshëm nis me sigurinë publike”. Të rinjtë u njohën me punën e policisë për sigurinë në rrugë, me procedurat rutinë të kontrollit, monitoruan dhe këshilluan së bashku me punonjësit e policisë përdoruesit e automjeteve. Ky aktivitet u mirëprit nga të rinjtë. Disa prej tyre shprehën interesin për të vazhduar studimet në Akademinë e Sigurisë.

Aktivitet ndërgjegjësues mbi sigurinë në rrugë me nxënësit e gjimnazit “Partizani” të Tiranës.



GBi – Health & Safety Academy, grantmarrëse e raundit të 5-të të skemës së granteve të Programit SCPA, në bashkëpunim dhe me mbështetjen e DVP Tiranë, organizoi në datën 10 mars 2022 me nxënësit e klasave të 12-ta të Gjimnazit “Partizani”, aktivitetin ndërgjegjësues me tematikë sigurinë rrugore. Nxënësit maturantë së shpejti do të jenë kandidatë për tu pajisur me lejedrejtimi ndaj interesi dhe vëmendja për temat e trajtuara ishte i madh.

Në këtë orë tematike u trajtuan tema të tilla si: përdoruesit e rrugës si këmbësorë, ciklistë, motociklistë, drejtues mjete; në lidhje me rrugën dhe elementet e saj; sistemet e sigurisë në mjete (rripi i sigurimit, kaska mbrojtëse); parandalimi i aksidenteve duke rritur vetëdijen qytetare dhe duke respektuar rregullat e qarkullimit rrugor; video me tematike përdorimin e rripit të sigurimit.

Takime me të rinj mbi policimin në komunitet, Librazhd



Forumi i Gruas Elbasan, më 10 Mars 2022 në kuadër të projektit “Ndërveprimi mes Policisë së Shtetit, aktorëve lokal dhe komunitetit në lidhje me Dhunën në Familje dhe Dhunën me Bazë Gjinore”, realizoi takimin e ndërgjegjësimit me të rinjtë e shkollës së mesme “Ibrahim Muço”, Librazhd.

Qëllimi i takimit ndërgjegjësues ishte rritja e nivelit të informacionit dhe sensibilizimi i të rinjve mbi fenomenet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, siguria qytetare, partneriteti polici – qytetar.

